



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:035190

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05875875

KF.nr.275/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Tire Center” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810196669 dhe seli Ferizaj, përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekti i kontestit rivlerësim doganorë, vlerë e kontestit 59,404.81 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 18.06.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Kushtrim Bytyqi Avokat dhe në prani të përfaqësueses të autorizuar të palës së paditur Alberije Hoxha Dedushi, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Tire Center” Sh.P.K., me seli në Ferizaj.
- II. ANULOHET PJESËRISHT Aktvendimi me nr. 01.3.2.2/12629/14698 i datës 03.12.2020, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë dhe atë në pikën I të diapozitivit të aktvendimit.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Tire Center” Sh.P.K., me seli në Ferizaj t’ia kthej shumën prej 59,404.81 € (pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqindën e katër euro e tetëdhjetë e një cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. R-33768/08.10.2020, 32684/02.10.2020, 32687/02.10.2020, 32486/30.09.2020, 31878/25.09.2020, 31873/25.09.2020,

31241/21.09.2020, 30564/16.09.2020, 30563/16.09.2020, 34836/15.10.2020,
34883/15.10.2020, 35081/17.10.2020, 35558/20.10.2020, 35719/21.10.2020,
35721/21.10.2020, 35953/22.10.2020, 37921/04.11.2020, 37923/04.11.2020,
38146/05.11.2020, 37998/05.11.2020 dhe 38002/05.11.2020, të proceduar në ZBD
Prizren me kamatë ligjore 8 % nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi 18.06.2024, e deri
në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

- IV. MBETET NË FUQI pika II e diapozitivit të Aktvendimit me nr. 01.3.2.2/12629/14698 të datës 03.10.2020 i Doganës së Kosovës, si jo kontestuese.
- V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Tire Center” Sh.P.K., me seli në Ferizaj, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 24.02.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet si i pabazuar dispozitivi I i Aktvendimit të paditurës me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën, ndërsa pjesa e Hedhur Poshtë nuk është kontestuese, dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara në emër të detyrimeve të importit të paguara më tepër mbi vlerën e transaksionit. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbesin në tërësi si në të theksuarat në padi si dhe nga deklaratimet në seancat e kaluara. Tutje ka shtuar se me anë të provave të bashkangjitura lëndës e të elbaoruara më në detaje në pikën tre të padisë vërtetohet çmimi i paguar nga paditësi në emër të mallrave të importuara dhe kjo do të duhej të merrej si bazë doganore për llogaritjen e detyrimeve doganore nga e paditura. Sa i përket vlerës së kontestit dhe propozimit për nxjerrjen e ekspertizës financiare e njëjta tashmë nuk është e nevojshme sepse vlera e kontestit nuk është kontestuese pasi që llogaritja e diferencës së paguara për shkak të rivlerësimit ka dalë të jetë e njëjtë me shërbimet e brendshme të paditurës. Prandaj e ka precizuar kërkesëpadinë në shumë prej 59,404.81 € të cilat ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që t’ia kthej paditësit së bashku me kamatën e grumbulluar në shkallë prej 8% nga data 03.12.2020 kur është nxjerrë aktvendimi refuzues i të paditurës e deri në kthimin e plotë të këtyre mjeteve. Ndërsa në fjalën përfundimtare gjykatës i ka propozuar të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar ashtu që të anulohet aktvendimi i atakuar dhe të detyroj të paditurën që ti kthej paditësi mjetet e paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të

mallrave sipas DUD-ave kontestues në vlerë të përgjithshme prej 59,404.81 € me kamatë në shkallë prej 8% nga data 03.12.2020 e deri në pagesën e plotë.

E paditura në përgjigje në padi të datës 03.02.2022 e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i palës së paditur ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe deklarimeve në seancën paraprake duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi pasi që aktvendimi i të paditurës është marrë konform dispozitave ligjore të KDA-së dhe se për këto mallra janë aplikuar çmimet nga dosja e vlerës-të dhënave të disponueshme. Më tej ka shtuar se paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ka bashkangjitur deklaratën eksportuese të shtetit eksportues me të cilën do të vërtetohej vlera dalëse e mallit nga shteti eksportues. Sa i përket vlerës së kontestit të njëjtat i kemi përcjelle gjykatës e cila është në shumë prej 59.404.81 €. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se mbesin në tërësi pranë deklarimeve si më lartë duke i propozuar gjykatës që ti falë besimin provave të cekura në aktvendimin e atakuar në padi pasi që për këto mallra janë përpiluar çmime bazuar në marka të ndryshme dhe ka ardhur deri te çmimi real i tregut. Andaj gjykatës i ka propozuar që nga provat e administruara të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke e lënë në fuqi vendimin e atakuar si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor gjyqësor-publik të datës 18.06.2024, ka administruar provat si në vijim: DUD-at kontestues dhe faturat përcjellëse, Faturë e datës 06.08.2020 dhe urdhërpagesë bankare, Kontratat e shitblerjes: 06.08.2020, 02.06.2020, 17.08.2020, 27.08.2020, 24.08.2020, 31.09.2020, 07.08.2020, 14.09.2020, 14.09.2020 (20YFTCL01-08-WINTER), 21.09.2020, 19.09.2020, Urdhërpagesat:14.09.2020, 20.06.2020, 21.09.2020, 22.09.2020, 28.09.2020, 29.09.2020, 07.08.2020, 14.10.2020, 14.10.2020 (kodi 111), 27.10.2020, 27.10.2020 (vlerë 52,924.80 USD) dhe konfirmimet Swift, Aktgjykimi nr.116/19, Aktgjykimi nr.1035/19, Aktgjykimi

1036/19, Vendimi kontestues 01.3.2.2/12629/14698 i datës 03.10.2020, Aktvendimi 01.3.2.2/1322 i datës 12.03.2020; Aktvendimi 01.3.2.2/698 i datës 13.03.2020; 01.3.2.2/262,1635 i datës 10.03.2020; Aktvendimi 01.3.2.2/2763-2019, Proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Dosja me të dhënat e disponueshme, kërkesë për rishqyrtimin e deklaratave doganore e datës 12.10.2020, dhe Parashtresat e datës 10.05.2024 dhe 23.05.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur për Dokumentet Unike Doganore ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë me e vogël se sa vlera reale e paguar apo ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33, të Kodit Doganor dhe të Akcizës së Kosovës. Po ashtu ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e 6-të (gjashtë) të vlerësimit të neni 35 të Kodit Doganor dhe Akcizës të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, zhdoganimeve të mëhershme të mallit të ngjashëm, që pasqyron vlerën reale për këtë lloj të mallit, si dhe dosjes së vlerave, andaj edhe në rastin konkret ka vepruar drejtë kur si vlerë reference është marr çmimi i mallit nga dosja e vlerave, si dhe nga të dhënat e zhdoganimit të mëhershëm të mallit të ngjashëm. Po ashtu ka cekur se Dogana e Kosovës-Sektori për Rishqyrtimin e vendimeve me qëllim të marrjes së një vendimit të drejtë, duke marr parasysh edhe pretendimet e subjektit ankimor, ka hulumtuar dhe analizuar në sistemin Cognos dhe Asycuda dhe ka konstatuar se kemi importe tjera nga importues të tjerë për mallin e ngjashëm të zhdoganuar në periudhë të afërt kohore me mallin lëndor kontestues para dhe pas importit kontestues, me përshkrim të ngjashëm, pra që kanë të gjitha karakteristikat e njëjta të llojit të mallit dhe vlera e këtij malli është më e lartë se sa vlera e mallit kontestues.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-ve kontestues të Zyrës së Brendshme Doganore Prizren dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 59,404,81 €, mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se e paditura do të mund ta mbështetet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është paguar nga paditësi përmes urdhërpagesave ndërkombëtare me status të aprovuar, e të cilat janë në harmoni të plotë në kuptim të shumës dhe përshkrimit si në faturë.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga zhdoganimet e mëhershme të zhdoganuar në periudhe të afërt kohore me mallin lëndor kontestues, në bazë të të cilës vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës sipas zhdoganimeve të mëhershme, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është përcaktuar që “*Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të*

parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është përcaktuar që dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”.*

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturat e mallit lëndor të cilat janë paguar përmes urdhërpagesave bankare ndërkombëtare me status të aprovuar, e të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të shumës dhe pagesës së bërë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDA-së.

Gjykata konstaton se aplikimi i metodës së gjashtë të vlerësimit në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, për arsye se para se të aplikohet metoda e fundit e vlerësimit gjegjësisht metoda e gjatë e vlerësimit duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor.

Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi pjesërisht vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t’ia kthej shumën prej 59,404.81 €, të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratave Unike Doganore me nr. DUD-ve R-33768/08.10.2020, 32684/02.10.2020, 32687/02.10.2020, 32486/30.09.2020, 31878/25.09.2020, 31873/25.09.2020, 31241/21.09.2020, 30564/16.09.2020, 30563/16.09.2020, 34836/15.10.2020, 34883/15.10.2020,

35081/17.10.2020, 35558/20.10.2020, 35719/21.10.2020, 35721/21.10.2020, 35953/22.10.2020, 37921/04.11.2020, 37923/04.11.2020, 38146/05.11.2020, 37998/05.11.2020 dhe 38002/05.11.2020, të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore prej 8% nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi 18.06.2024, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi

Gjykata konstaton se shumata e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasojë e rivlerësimit të mallit nga e paditura nuk u kontestua as nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor i cili theksoi se: *Sa i përket vlerës së kontestit të njëjtat i kemi përcjell gjykatës e cila është në shumë prej 59,404.81€.*

Lidhur me pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimit gjykata e ka lënë në fuqi pikën II të aktvendimit kontestues nr. 01.3.2.2/12629/14698 të datës 03.12.2020, kjo për faktin se paditësi në padinë e tij ka theksuar se pjesa e hedhur poshtë në drejtim të DUD-it R-34394/13.10.2020 nuk është kontestuese, andaj edhe gjykata nuk është lëshuar më tej në elaborimin dhe vlerësimin e të njëjtës.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, sipas precizimit të kërkesëpadsisë nga i autorizuari i paditësit bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.06.2024 duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet “*Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluësit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme*” dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se “*Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit*” dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se “*Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”, ndërsa si moment të fillimit të kamatës mori datën e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, në mungesë të dëshmisë se pagesës së detyrimeve doganore të rivlerësuara.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform nenit 46 par. 1,2, 3, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.275/22, datë 18.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.